

VENDIM
Nr. 5, datë 10.5.2017

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të neneve 28 dhe 29 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë” të ndryshuar, rregulloren e brendshme “Për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit të Shqipërisë”, nenit 9 dhe 22 të ligjit nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, udhëzimit nr. 2, datë 6.2.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, udhëzimit nr. 22, datë 22.11.2016 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”, manualit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, seksioni “delegimi i detyrave”.

VENDOSA:

1. Në mungesë, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave, si nëpunëse e autorizuar, delegoj Znj. Etleva Zeqo, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Administrativ, për kryerjen e pagesave për të gjithë zërat e shpenzimeve.
2. Kryerja e pagesave për shpenzimet në artikujt 600 dhe 601 i delegohen Znj. Etleva Zeqo, Drejtore e Përgjithshme e Shërbimit Administrativ, pavarësisht nëse nëpunësi autorizues është apo jo në mungesë, apo në pamundësi të ushtrimit të kompetencave.
3. Kompetencat e deleguara, do të ushtrohen nga data 10.5.2017 deri në datën 31.12.2017.
4. Raportimi të kryhet tek nëpunësi Autorizues, me shkrim çdo muaj pasardhës, për realizimin e detyrave të ngarkuara.
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM
Albana Shtylla